

Partia i ka kushtuar gjithnjë vëmendje të veçantë edukimit të fëmijëve. Një ndër dëshmitë e shumta të kujdesit të madh prej prindi është edhe ngritja e teatrove profesioniste të kukullave në qytete të ndryshme. Ky teater është kreu i tyre. Aty të vegjlit marrin edukimin politik dhe ideologjik nëpërmjet mjeteve artistike, shprehëse, të cilët përpunojnë shijet e tyre.

...

Puna e teatrit të kukullave ka specifikën e vet artistike. Në qoftë se aktori i teatrit me njerëz, transmeton lojën e tij në mënyrë të drejtpërdrejt, aktori i teatrit të kukullave fshihet pas paravanit e kreu puna e tij transmetohet nëpërmjet kukullës-aktor. Sigurisht, procesi i punës së regjizorit dhe aktorëve është i njëjtë për një pjesë: puna në tryezë, fuaje, në skenë. Dihet se pjesa teatrale me kukulla si kohë është më e shkurtër, por edhe ajo ka një fabul, një gërshetim dramatik, një konflikt të përcaktuar qartë, ku gjithnjë triumfon e reja, ashtu si në jetë. Pra, e reja, e bukura, e mira, fisnikja janë në qendër të krijimtarisë artistike për fëmijë, sepse ato kanë forcë të madhe edukuese. Edhe pse pjesa është për të vegjël, puna duhet bërë me seriozitet si për të mëdhenjtë dhe spektaktli duhet të tingëllojë i vërtetë, bindës, i afërt, i kuptueshëm dhe i larmishëm; të ketë rritje nga skena në skenë, të zbulohet bota e brendshme e personazheve.

Spektakli ndërtohet mbi një numër faktorësh artistikë, por kryesorin në të është aktori. Ai është përcuesi i mendimit dhe i emocionit. Në një masë të madhe puna e tij mbështetet mbi tekstin, por të kërkojë të metat apo sukseset vetëm tek teksti do të thotë ta shohësh problemin nga një kënd i ngushtë. Spektaklin e organizon regjizori, i cili duhet ta zgjedhë pjesën edhe si vlerë letrare edhe si temë dhe ta shohë se çfarë problemi ngre ajo. Fëmijët, si spektatorë, kanë kërkesat dhe shijet e tyre që nuk janë të pakta dhe jashtë realitetit tonë. Edhe pse kanë kaluar 30 vjet nga dita e Çlirimit, e kjo është një largësi e madhe kohe që e ndan fëmijën nga Lufta Nacionalçlirimtare, prapë ai i ndan kategoritë e njerëzve të mirë në partizanë, kurse të këqinjët në gjermanë, tradhtarë, E kjo është mjaft domethënëse.

Kemi kërkuar që në punën e çdo sektori të futet të kuptuarit e rolit jo në sipërfaqe, por në thellësi, me veçoritë e karakteristikat e tij, qoftë kafshë apo njeri, edhe gënie e përfytyruar, si shtatë pëllëmbëjekri etj., duke mos u shkëputur asnjë çast nga rruga e

zhvillimit të personazhit, në lidhje të kushtëzuar prej partnerëve të tjerë.

Në shumicën e premierave spektatorit i vogël duhet konsideruar partner. Prandaj, në disa çaste dramatike ne e thërresim atë të mbajë qëndrim, të japë gjykim për diçka që zhvillohet në skenë; me një fjalë, e bëjmë të aktivizohet gjatë shfaqjes. Kjo ka efekt të

sensin e masës, që luan rol shumë të rëndësishëm në shfaqje të tilla.

Krahës këtij problemi edhe gjuha si mjeti kryesor që lidh aktorin me spektatorin, duhet shqyrtuar e përpunuar në të gjitha aspektet e saj, sepse sa më mirë të flasim, sa më bukur e sa më pastër, sa më të kuptueshëm dhe sa më shumë mendim e ndjenjë të ketë fjala, aq më shumë do të

Fëmijët janë shumë dashamirës për Teatrin e Kukullave. Ata e duan këtë teater se është i tyre.

\*\*\*

Teatri i kukullave tek ne në përgjithësi ka përparuar mjaft dhe për këtë arsye ka fituar respektin e të vegjëlve dhe të mëdhenjve, nga të cilët vlerësohet lart për funksionin shoqëror që ka. Megjithatë ka disa të meta që duhen kapërcyer. Kështu p.sh. nga ana teknike kukulla punohet dobët: ajo ka mbetur memece, e verbër dhe shumë stereotipe. Prodhimi i kukullave në seri mbi baza artizanale, çënon në mënyrë flagrante konceptin mbi personazhet dhe krijon monoton; në punën e aktorit, sepse ndryshe e përfytyronte regjizori dhe aktori figurën (ose figurat) e kreu ndryshe i serviren nga punishtja. Prodhimi i kukullave në këtë formë bëhet forcë frenuese dhe krijon kontradiktë të madhe me gjithçka që e përbën spektaklin, sepse të gjitha mjetet flasin, ndërsa kukulla qëndron e ngrirë në heshtjen e saj butaforike. Në pjesën «Kush hyri në thes», ne provuam dhe ua hapëm gojë të gjitha kukullave. Kjo bëri që të dallohet mirë se cila nga kukullat është duke folur, sepse jo vetëm shihej hapja dhe mbyllja e gojës, por tërë figura gjallërohej me shumë dhe interpretimi i aktorit trettej edhe më mirë me veprimet e kukullës gjë që e afroi edhe më shumë spektatorin e vogël me lojën.

Eshtë koha të heqim dorë nga prodhimet e kukullave me grimca letrash, me qirish dhe allçi mbi formën «kallëp», e cila ka një proces mjaft të gjatë tharjeje (sidomos për stinët vjeshtë-dimër). Të kërkojmë e të gjejmë materiale të tjera për këtë punë artistike me shumë rëndësi, që lejojnë të thyhen linjat artizanale, që kukullat të flasin e të shohin, të jenë më të lehta në përdorim për t'u gjallëruar dhe shpirtëzuar më shumë. Nish-Goma mund të prodhojë diçka të nevojshme për punën me kukulla jo si formë, sepse atëhere do të binim në standartizim industrial, por një lëndë që mund të përdoret nga specialistët e kukullave për këtë qëllim, sipas kërkesës së regjizorëve të teatrove.

Teatrove tona të kukullave u është ngarkuar një detyrë e rëndësishme dhe për këtë qëllim Partia u ka hapur perspektiva të mëdha zhvillimi. Mirëpo ky zhvillim arrihet vetëm me luftë këmbëngulëse kundër çdo shfaqjeje frenuese, me një edukim politik dhe ideologjik lidhur me punën e përditshme, duke bërë bazë të punës sonë mësimet e Partisë, të cilat kanë qenë, janë dhe do të jenë, burim frymëzimi revolucionar.

## Edhe më shumë cilësi në punën e teatrit të kukullave

Jonuz Dini


ndjeshëm jo vetëm psikologjik, por edhe pedagogjik: zgjon interesin në shkallë të lartë, ushtron vëmendjen, shkathtësinë, aftësinë mendore të perceptimit viziv dhe auditiv në një kohë, për të mbajtur qëndrim të menjëhershëm ndaj asaj që ndodh në skenë. Përgjithësisht replikat e spektatorëve janë logjike dhe kanë lidhje organike me tekstin e spektaktit. Fëmijët shpallen që në batutat e para partizanë të vendosur të së mirës dhe të dobishmes.

Rëndësi mjaft të madhe ka edhe e folmja e pjesës, si ndërtim dramatik. Fëmijët në përgjithësi nuk durojnë fjalët e kota, dialogje të zgjatura, deklarata, shpjegime të hollësishme. Këto i lodhin shumë ata, i bëjnë nevrrikë, i mërzhisin deri në atë shkallë sa shkëputen tërësisht nga shfaqja e nisin e bisedojnë për gjëra të tjera që mund t'i tërheqin më shumë, bëjnë zhurmë dhe e prishin kështu gjithë punën e aktorëve, që mundohen më kot për të dalë mbi zërat e spektatorëve. Fëmijët, për vetë natyrën e moshës, perceptojnë më lehtë mendimin që shprehet nëpërmjet veprimit praktik se sa përmes fjalëve, nuk mbajnë rezervë, ta thonë aty për aty përshtypjen e tyre për shfaqjen. Prandaj dialogjet dhe monologjet duhet të jenë koncizë, të shkaktë, të trefren në veprimin dramatik. Fëmijët duan ngjarje, ndërthurje interesante, ndeshje, aktivitet. E gjithë kjo lidhet me

edukojë të vegjlit me një ndjenjë të thellë respekti e dashurie për gjuhën amtare. Duhet jo vetëm zbatim i tekstit letrar, dhe jo vetëm zbatim formal i tij, por një drejtshqiptim i plotë. Sigurisht kjo nuk bëhet menjëherë, por duhet bërë përpjekje për ta arritur sa më shpejt. Shumë e dëmshme ka qenë për teatrin në përgjithësi praktika e kthimit të tekstit në të folmet krahinore për t'i lehtësuar punën aktorit. Puna e madhe që është bërë për të folur kudo gjuhën e pastër letrare e ka përmirësuar shumë dhe cilësinë e spektaktave.

Turneu që bëri Teatri i Kukullave i Shkodrës në Vlorë, Durrës edhe Tiranë, para një mase prej rreth dymijë fëmijësh, të cilët u rrëmbyen nga këto shfaqje u bë në partnerë të aktorëve, njëloj si të vegjlit shkoçranë, ishte një provë e kënaqshme se kjo trupë kish përparuar mjaft në gjuhën letrare.

Disa herë kemi përdorur një metodë të re për të përmirësuar shfaqjet tona: takimin me prindërit. Në bashkëpunim me bashkimet profesionale të rrethit, ftuam një numër punëtorësh, me të cilët në fund të shfaqjes dëgjua mendimin e tyre lidhur me nivelin artistik të punës sonë dhe me efektin edukativ të saj. Ky takim dha rezultate të kënaqshme. Ka patur raste që kemi bërë takime me të vegjlit, ose fill pas shfaqjes, ose në klasë.



Pamje nga shfaqjet «Punë e dëfrim» dhe «Gracka» të Teatrit Qendror të Kukullave Tiranë.